

Gjinia dhe korrupsioni

*hulumtimi për Republikën
e Maqedonisë së Veriut*



GJINIA DHE KORRUPSIONI

RAPORT NGA HULUMTIMI
I PERCEPTIMIT TË
FORMAVE GJINORE
TË KORRUPSIONIT
NË MAQEDONINË E VERIUT

qershor 2021, Shkup

RAPORT
I HULUMTIMIT CILËSOR
PËR PERCEPTIMIN E FORMAVE
GJINORE TË KORRUPSIONIT
NË MAQEDONINË E VERIUT

shtator 2021, Shkup

TITULL:

Gjinia dhe korrupsioni

Hulumtimi për Republikën e Maqedonisë së Veriut

Autorë:

TIM Instituti

**Përktheu dhe
lekturoi:**

BESTEL DOOEL Skopje

ISBN: 978-92-9271-007-1

www.osce.org/skopje

© OSCE Mission to Skopje 2022



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të shfrytëzohet dhe shumëzohet për qëllime arsimore dhe qëllime tjera jokomerciale, me kusht që gjatë çdo riprodhimi të tillë si burim të ceket Misioni i OSBE-së në Shkup.

Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	6
RAPORTI METODOLOGJIK	8
STRUKTURA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARAVE	10
1. Korrupsioni si problem	12
2. Tendencat për korrupsion	13
3. Zhvatja e shërbimeve seksuale	14
4. Prania e zhvatjes seksuale në institucione	16
5. Përvojat personale	18
6. Gratë në pozita udhëheqëse	23
7. Dallimi i formave specifike të korrupsionit	24
GJETJET KRYESORE	26

PËRMBAJTJA

1. KONSTATIMET KRYESORE NGA HULUMTIMI	30
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	32
3. PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN NË VEND	33
3.1 Asociacione spontane për korrupsion	33
3.2 Ku është më i pranishëm korrupsioni?	33
3.3 Nënshtrimi ndaj korrupsionit	34
4. PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT GJINOR NË VEND	36
4.1 Mënyra të ngritjes së vetëdijes dhe edukimit të publikut për korrupsionin gjinor	38
5. PËRVOJAT LIDHUR ME KORRUPSIONIN GJINOR DHE MËNYRËN E REAGIMIT	40
5.1 Çfarë do t'i kishte inkurajuar që ta ndjekin rrugën institucionale?	44
6. PROFILI I VIKTIMËS SË KORRUPSIONIT GJINOR	46
7. AKTIVITETI QYTETAR LIDHUR ME KORRUPSIONIN GJINOR	47

RAPORT NGA HULUMTIMI I PERCEPTIMIT TË FORMAVE GJINORE TË KORRUPSIONIT NË MAQEDONINË E VERIUT



PËRMBLEDHJE

Për shkak të një hulumtimi sasior më të detajuar të gjendjes me format gjinore të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV), në periudhën nga 02.06.2021 deri në 09.06.2021 Agjencia Hulumtuese TIM Institute zhvilloi një sondazh të opinionit publik në një mostër reprezentative prej 1013 të anketuarave të moshës 18 vjeç e më lart, që jetojnë në amvisëri në territorin e RMV-së.

Sipas gjetjeve, shtatë nga dhjetë gra detektojnë probleme të mëdha që lidhen me korrupsionin dhe shtrirjen e gjërë të tij në vendin tonë.

Me interes të veçantë në këtë hulumtim ishte zhvatja e shërbimeve seksuale nga të punësuar në sektorin publik, në këmbim të ofrimit të një shërbimi publik, si një formë specifike gjinore e korrupsionit. Prandaj, zhvatjen e shërbimeve seksuale nga të punësuarit e sektorit publik, në këmbim të ofrimit të një shërbimi publik si një formë korrupsioni, **e njohin 78% e të anketuarave**. Vetëm një në dhjetë të anketuara besojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale nga të punësuarit e sektorit publik në këmbim të ofrimit të një shërbimi publik nuk paraqet një formë korrupsioni.

Mbi gjysma e të anketuarave potencojnë se bartësit e funksioneve dhe kompetencave publike që kanë pushtet ndodh të kërkojnë shërbime seksuale në vend të parave/ryshfetit, në këmbim të dhënies së shërbimit publik për të cilin janë kompetentë. Brengos fakti se 21.5% e tyre janë shprehur se kjo ndodh **shpeshherë**.

Se zhvatja nuk është prezente vetëm në sektorin publik, por ndodh edhe në sektorin privat, deklarohen dy të tretat e të anketuarave. Personat që janë në pushtet më së shpeshti kërkojnë shërbime seksuale në shkëmbim të dhënies së shërbimit publik, si **punësimi dhe avancimi në punë**.

Vërehet se mbi 63% e të anketuarave **nuk lajmërojnë përvojë personale e as të huaj**, e që ka të bëjë me këtë formë korrupsioni. Një e katërta e të anketuarave theksojnë se nuk kanë pasur përvojë të tillë personale, por njohin dikë që ka përjetuar këtë formë korrupsioni dhe 5,4% të anketuara që **personalisht** kanë përjetuar dhe janë ballafaquar me pasojat e zhvatjes së shërbimeve seksuale. Nga këto 54 të anketuara (5,4%), vetëm 20 kanë shprehur gatishmërinë ta **lajmërojnë** këtë presion dhe të ballafaqohen me sfidën e zbulimit të kësaj përvoje.

Tendenca e mosraportimit të zhvatjes së shërbimeve seksuale, që vërehet nga përgjigjet e të anketuarave, shënon rënie graduale kur ato u pyetën se a do ta kishin lajmëruar rastin nëse në të ardhmen, hipotetikisht, do t'u kishte ndodhur diçka e ngjashme. Në këtë pyetje përgjigjeshin vetëm të anketuarat që paraprakisht nuk kanë raportuar përvojë të deritanishme të zhvatjes për shërbime seksuale. Nga gjithsej 95%, gjysma do të kishin marrë guximin ta raportojnë rastin, por brengos fakti që 15% e të anketuarave këtë nuk do t'ia tregonin askujt. Më së shpeshti kjo ndodh për shkak të mosbesimit në sistem, duke u përgjigjur se raportimi **nuk do të ketë asnjë efekt**.

Policia është institucioni që përmendet më së shpeshti ku të anketuarat do ta kishin paraqitur rastin e zhvatjes së shërbimeve seksuale.

Ndërlidhja e nivelit të korrupsionit në vend me emërimin e grave në pozita udhëheqëse po ashtu ishte temë interesi. Më shumë se gjysma e të anketuarave (53,5%) konsiderojnë se niveli i korrupsionit në vend do të kishte pësuar rënie nëse më shumë gra do të ishin zgjedhur/emëruar në pozita më të larta udhëheqëse.

Numri më i madh i të anketuarave (mbi 70%) konsiderojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale si një formë specifike korrupsioni nuk njihet dhe nuk dallohet mjaftueshëm në opinion – në diskutime, në politikat dhe aktet ligjore në vendin tonë. Kjo paraqet sinjal të qartë se duhet të gjenden mekanizma të avancimit të diskutimit, të ndiqet gjendja dhe të informohet publiku për temat që kanë të bëjnë me zhvatjet e shërbimeve seksuale. Përgjigjet e një të katërtës së të anketuarave që konsiderojnë se nuk dinë aspak për zhvatjen seksuale si formë korrupsioni në vend tregon se opinionin publik nuk bën dallimin e aspekteve gjinore të korrupsionit.

RAPORTI METODOLOGJIK

Në këtë hulumtim është përdorur mostër e stratifikuar reprezentative e popullatës femërore në Maqedoninë e Veriut. Hulumtimi u zhvillua mbi gjithsej 1013 të anketuara, në moshë 18 vjeçe e më lart, që jetojnë në amvisëri në territorin e RMV. Përzgjedhja e të anketuarave në amvisëri bazohet në parimin se cila prej tyre ka e para ditëlindjen e radhës (nëse në amvisëri ka më shumë se një përfaqësuese të gjinisë femërore). Amvisëritë janë përzgjedhur proporcionalisht, në vendbanime urbane dhe rurale në kuadër të komunave përkatëse.

Për qëllimet e hulumtimit intervistat u zhvilluan me bisedë telefonike.

KONCEPTI I MOSTRËS

Fillimisht popullata është stratifikuar në 3 variabla: përkatësi etnike, shkallë urbanizimi dhe rajon. Janë definuar kategori sipas këtyre tri variablave kyç.

Pastaj, çdo komunë në një rajon është ndarë në 4 nëngrupe: maqedonase etnike dhe të përkatësive të tjera etnike në vendbanime urbane dhe rurale, dhe shqiptare etnike në vendbanime urbane dhe rurale (konform përfaqësimit të bashkësive etnike në komunën përkatëse).

Më tej, numri i paraparë i intervistave në çdo komunë është shpërndarë proporcionalisht sipas numrit të banorëve në komunë (stratifikim i popullatës). Në fakt, çdo qeli është funksion i numrit të targetuar të intervistave (numri i paraparë i mostrës), numrit të përgjithshëm të banorëve në komunë dhe numrit të banorëve në nëngrupin përkatës.

PËRZGJEDHJA E AMVISËRIVE DHE TË ANKETUARAVE

Secili anketues duhet të bëjë së paku tri përpjekje për të vendosur kontakt telefonik me amvisërinë e përzgjedhur. Nëse gjatë orarit të punës edhe pas tri përpjekjeve nuk është vendosur kontakt me amvisërinë përkatëse, kontaktohet me një amvisëri tjetër, sipas procedurës së përzgjedhjes së amvisërisë.

Anketuesit i shënojnë rezultatet e të gjitha përpjekjeve për të vendosur kontakt në të ashtuquajturën listë kontaktesh.

Në një amvisëri mund të anketohet vetëm një person i përzgjedhur.

SISTEMI PËR KONTROLL CILËSIE

Rreth 25% e intervistave të zhvilluara janë objekt kontrolli.

RRJETI I ANKETIMIT DHE MBIKËQYRJES

Sondazhin e realizuan një rrjet i zhvilluar dhe me përvojë i anketuesve (telefonistë), në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Në këtë projekt ishin të angazhuar 20 anketues me përvojë.

KOHËZGJATJA E HULUMTIMIT

Para fillimit të sondazhit telefonik, të gjithë anketuesit kishin trajnim teorik për metodologjinë dhe procedurën e punës, që përfshin shpjegim për rëndësinë dhe zbatimin e procedurave më poshtë:

- ▲ Përzgjedhja e amvisërisë;
- ▲ Përzgjedhja e të anketuarës;
- ▲ Shpjegim për metodën e plotësimit të pyetësorit programatik.

Hulumtimi u zhvillua nga 02.06.2021 deri më 09.06.2021.

Anketuesit e kishin për detyrë që çdo ditë t'i raportojnë udhëheqësit të projektit për progresin e projektit lidhur me vështirësitë eventuale me të cilat ballafaqohen, si dhe lidhur me arsyet eventuale për refuzimin e sondazhit.

Softueri profesional për përpunimin statistikor të të dhënave SPSS për Windows u përdor për procesimin dhe analizimin e të dhënave të mbledhura.

SPSS për Windows dhe Microsoft Office për Windows (Word dhe Excel) u përdorën për përgatitjen e raportit, grafikëve dhe tabelave.

PËRQINDJA E KONTAKTEVE TË REALIZUARA DHE REFUZIMEVE

Numri i kontakteve	1.450
Numri i përgjithshëm i intervistave të realizuara	1.013
Përqindja e intervistave të realizuara	69,86 %

Përshtypjet e rrjetit anketues ishin se gatishmëria dhe interesi i përgjithshëm mes të anketuarave ishte relativisht i mirë.

U realizua një numër i madh kontaktesh. Ndonëse anketuesit u ballafaquan me refuzime, kjo ishte në vijë me pritshmëritë, siç ndodh në shumicën e hulumtimeve të opinionit publik.

Refuzimet për pjesëmarrje në këtë sondazh në të shumtën e rasteve kishin të bëjnë me arsyetimin se “nuk ka kohë”, ndërsa të tjerat ishin se “nuk ka disponimin të përgjigjet” ose “ka marrë pjesë në një sondazh para jo shumë kohësh”.


STRUKTURA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARAVE

GJINIA



Femërore

GJINIA



ARSIMI

Fillor



20,2%

I mesëm




55,8%

I lartë




24%

PËRKATËSIA NACIONALË



RAJON



VENDBANIMI




Urban
58,8%




Rural
41,2%

STATUSI I PUNËSIMIT



TE ARDHURA MUJORE FAMILJARE



1. KORRUPSIONI SI PROBLEM

Grupi i parë i pyetjeve ka të bëjë me perceptimin e të anketuarave rreth shtrirjes së korrupsionit. Në grafikun më poshtë paraqitet se deri në çfarë mase trajtojnë ato korrupsionin si problem, sidomos në jetën e përditshme, në komunë dhe në shtetin ku jetojnë.

Vërehet se në të tri fushat e ofruara, të shumtën e rasteve të anketuarat e perceptojnë korrupsionin si problem.

Në jetën e përditshme, 38% kanë theksuar se korrupsioni paraqet problem të madh, 31% janë shprehur se korrupsioni është problem i vogël, ndërsa për 28% e të anketuarave korrupsioni aspak nuk paraqet problem në jetën e tyre të përditshme. Sa i përket korrupsionit në komunën ku jetojnë, përqindja e përgjigjeve se ai paraqet problem të madh shënon rritje. Më shumë se gjysma (51%) e të anketuarave theksojnë se është problem i madh, rreth një e treta (32%) se është problem i vogël, ndërsa vetëm 8% shprehen se në komunën e tyre korrupsioni nuk është aspak problem.


Se korrupsioni paraqet problem të madh në shtetin tonë pajtohen shtatë nga dhjetë të anketuara (77%).

Analiza plotësuese e të dhënave tregon se korrupsioni si problem i madh në **jetën e përditshme** kryesisht përmendet nga të anketuarat e moshës 45–54 vjeç, më shumë se dyfish shqiptaret në raport me maqedonaset (70% kundrejt 28%), më shpesh nga të papunësuarat dhe të punësuarat në sektorin publik, dhe ato me të ardhura personale mujore më të ulëta.

Korrupsioni si problem i madh në **komunë** kryesisht përmendet nga të anketuarat në moshë 45–54 vjeç, më shumë nga shqiptaret kundrejt maqedonaseve, më shumë nga amviset dhe të punësuarat në sektorin publik, dhe ato me të ardhura personale mujore më të ulëta.

Korrupsioni si problem i madh në **vend** kryesisht përmendet nga të anketuarat në moshë 25–34 vjeç dhe 45–54 vjeç, të anketuarat me arsim të lartë, të punësuarat në sektorin publik, dhe ato me të ardhura personale mujore nga 24.000 deri në 36.000 denarë.


Grafiku 1. Sipas mendimit Tuaj, a është korrupsioni problem i madh, problem i vogël apo nuk është aspak problem?



2. TENDENCAT PËR KORRUPSION

Tendencat për korrupsion, shqyrtuar në prizmën e përgjigjeve të të anketuarave, tregojnë se korrupsioni është i pranishëm te të dy gjinitë. Rreth dy të tretat kanë theksuar se nuk bëjnë dallimin e aspekteve gjinore të korrupsionit, gjegjësisht burrat dhe gratë kanë tendencë të njëjtë korrupsioni. Rreth 15% e të anketuarave konsiderojnë se te gratë tendenca për korrupsion është më e vogël se te burrat, mirëpo 18% e mendojnë të kundërtën – se gratë kanë tendencë më të madhe për korrupsion në raport me burrat.


Grafiku 2. Sipas mendimit Tuaj, a kanë gratë tendencë të njëjtë për korrupsion si burrat (kush është më i korruptuar)?



Të anketuarat që janë shprehur se gratë kanë më shumë tendencë korrupsioni janë kryesisht përfaqësuese të grupmoshave më të reja, deri 24 vjeç, me arsim të mesëm, studente dhe më së kryesisht maqedonase (dyfish më shumë se shqiptaret).

Se korrupsioni ndikon në mënyrë të njëjtë edhe te gratë edhe te burrat, pajtohen gjashtë nga dhjetë të anketuara. Një të pestat e të anketuarave konsiderojnë se korrupsioni më shumë ndikon te gratë, e po aq mendojnë se korrupsioni më shumë ndikon te burrat. Kjo përqindje e të anketuarave (gjithsej 216) kryesisht përbëhet nga përfaqësuese të grupmoshës më të re deri në 24 vjeç.

Grafiku 3. A do të kishit thënë se korrupsioni ndikon në mënyrë të njëjtë edhe ndaj grave edhe ndaj burrave?



3. ZHVATJA E SHËRBIMEVE SEKSUALE


Format e korrupsionit nënkuptojnë sjelljet e ndaluara lidhur me ryshfetin, në kryerjen e funksioneve publike. Ky term nënkupton shfrytëzimin e funksionit dhe pozitës për qëllime amorale ose joligjore, me qëllim të realizimit të një përfitimi personal. Korrupsioni si fenomen sociopatologjik paraqet dukuri konkrete dhe në të janë të involvuar persona konkretë. Rrjedhimisht, zhvatjen e shërbimeve seksuale nga ana e të punësuarve në sektorin publik, në shkëmbim të dhënies së një shërbimi publik si **formë** korrupsioni, e dallojnë 78% e të anketuarave.

Kodi ynë zgjedhor nuk njeh zhvatjen e shërbimeve seksuale si formë korrupsioni. Shërbimet seksuale përmenden në pjesët që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin në prostitucion, eksploatimin seksual dhe dhunën seksuale në pjesën e krimeve ndaj njerëzimit, robërinë seksuale në pjesën e krimeve ushtarake kundër popullatës civile, eksploatimin seksual në tregtinë me njerëz, por jo edhe zhvatjen e shërbimeve seksuale nga një person i pushtetshëm¹.

¹ <https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BD-%D1%82%D0%B5%D0%BA%D1%81%D1%82.pdf>

Vetëm një nga dhjetë të anketuarat konsideron se zhvatja e shërbimeve seksuale nga ana e të punësuarve në sektorin publik, në shkëmbim të dhënies së një shërbimi publik, **nuk** paraqet formë korrupsioni, ndërsa 12% kanë shprehur pamundësinë ta dallojnë korrupsionin në zhvatjen e shërbimeve seksuale.


Grafiku 4. A mendoni se zhvatja e shërbimeve seksuale nga ana e të punësuarve në sektorin publik, në shkëmbim të dhënies së një shërbimi publik, paraqet formë korrupsioni?



Të anketuarat që konsiderojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale nga ana e të punësuarve në sektorin publik në shkëmbim të një shërbimi publik paraqet formë korrupsioni, janë kryesisht maqedonase, me arsim të lartë, e që i përkasin grupmoshës prej 25 deri në 34 vjeç.

Rreth 59% e të anketuarave konsiderojnë se bartësit e funksioneve dhe kompetencave publike që kanë pushtet ndodh të kërkojnë shërbime seksuale në vend të parave/ryshfetit, në shkëmbim të dhënies së shërbimit publik për të cilin kanë kompetencë. Nga këto, 21.5% janë shprehur se kjo ndodh shpeshherë.


Grafiku 5. Në disa raste mund të ndodhë që persona të caktuar në pushtet, si për shembull bartësit e funksioneve dhe kompetencave publike ose të punësuarit në administratën publike, të kërkojnë shërbime seksuale në vend të parave/ryshfetit, në shkëmbim të dhënies së shërbimit publik për të cilin janë kompetent. Sa shpesh mendoni se kjo ndodh në shtetin tonë?



Dy të tretat e të anketuarave konsiderojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale në këmbim të sigurimit të një shërbimi publik ndodh si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

Se kjo formë e presionit të detyrueshëm ndodh më shumë në sektorin privat mendojnë 17% e të anketuarave. Të anketuarat janë kryesisht në moshë nga 45 deri në 54 vjeç, me arsim të lartë, por të punësuar njëjtë sa në sektorin publik, po aq edhe në sektorin privat.

Grafiku 6. A do të kishit thënë se zhvatja e shërbimeve seksuale në shkëmbim të sigurimit të një shërbimi publik më shumë ndodh ose më shumë mund të ndodhë në sektorin publik apo në sektorin privat?




4. PRANIA E ZHVATJES SEKSUALE NË INSTITUCIONE

Administrata shtetërore (në nivel qendror dhe lokal) është institucioni të cilin të anketuarat e konsiderojnë si institucion ku më së shpeshti ndodh zhvatje seksuale si formë korrupsioni. Përgjigjet e mbledhura “shpeshherë” dhe “ndonjëherë” përbëjnë dy të tretat e të anketuarave në RMV, e të cilat detektojnë keqpërdorim të funksionit ose kompetencave publike, me qëllim të sigurimit të shërbimeve seksuale në administratën shtetërore. Këto të anketuara kryesisht janë me arsim të lartë dhe të punësuar në sektorin publik, por në aspekt statistikor nuk vërehet dallim i theksuar në mes të përgjigjeve të tyre, të shqyrtuara në prizmën e përkatësisë nacionale dhe moshës.

Arsimi dhe shëndetësia janë institucionet e tjera ku më shumë se gjysma e të anketuarave mendojnë se ka prani të zhvatjes seksuale si formë korrupsioni (përgjigjet e mbledhura “shpeshherë” dhe “ndonjëherë” arrijnë 59.2% në arsim dhe 56.6% në shëndetësi).

Një e katërta e të anketuarave nuk ka mendim për prani të zhvatjes seksuale në institucionet e mbrojtjes sociale.

Grafiku 7. Nëse tashmë dini për zhvatjen seksuale si formë korrupsioni, sa shpesh mendoni se ndodh në institucionet e fushave të mëposhtme?



Përveç gjashtë fushave të ofruara në kuadër të të cilave institucione kishin mundësinë të shprehin mendimin e tyre për praninë e zhvatjes seksuale, të anketuarat detektuan edhe institucione të tjera për të cilat shprehën dyshime se kjo formë detyrimi është shpeshherë prezente:


Ndërmarrje private (77 të anketuara)

Notarë, avokatë (16 të anketuara)

Rastet më të shpeshta ku personat në pushtet kërkojnë shërbime seksuale në shkëmbim të dhënies së një shërbimi publik për të cilin janë kompetentë paraqiten në grafikun në vazhdim. Mbi 60% e të anketuarave konsiderojnë se më së shpeshti ato janë raste punësimi (64%) dhe avancimi në vend pune (63%).

Numër identik i të anketuarave (37%) konsiderojnë se personat në pushtet kryesisht kërkojnë shërbime seksuale në shkëmbim të sigurimit të një trajtimi më të mirë ose me qëllim të shmangies së një dënimi ose problemi që kanë ata që kërkojnë këtë lloj shërbimi.

Grafiku 8. Në cilat situata do të kishit thënë se personat në pushtet më së shpeshti kërkojnë shërbime seksuale në shkëmbim të dhënies së një shërbimi publik për të cilin janë kompetentë?




5. PËRVOJAT PERSONALE

Pyetja e radhës detekton përvojën e të anketuarave lidhur me zhvatjen e shërbimeve seksuale, pa marrë parasysh se a është përvojë personale ose e ndonjë shoqeje të tyre. I dukshëm është fakti se mbi 63% e të anketuarave nuk lajmërojnë as përvojë personale e as të huaj lidhur me këtë formë korrupsioni, por gjithsesi duhet të merret parasysh se raportimi i zhvatjes së shërbimeve seksuale lë hapësirë për etiketim nga shoqëria dhe pakëndshmëri, që pastaj reflektohet në jetën e mëtejshme të gruas.

Një e katërta e të anketuarave kanë theksuar se nuk kanë përvojë personale, por njohin dikë që ka kaluar në këtë formë korrupsioni dhe 5,4% e të anketuarave që personalisht kanë përjetuar dhe janë ballafaquar me pasojat e zhvatjes së shërbimeve seksuale.


Nga këto 54 të anketuara (5,4%), vetëm 20 kanë shprehur gatishmërinë ta raportojnë presionin dhe të ballafaqohen me sfidën e zbulimit të kësaj përvoje (37%).

Grafiku Q9. A keni pasur ju personalisht apo ndonjë e afërme juaja përvoja me zhvatje të shërbimeve seksuale në vend të kërkesave për para/ryshfet si formë korrupsioni (në raste kur keni kërkuar një shërbim të caktuar publik)?




Grafiku paraqet përgjigjet e 54 të anketuarave (si 100%) që kanë pasur përvojë personale me zhvatje të shërbimeve seksuale. Nga ato, 61,1% nuk kanë raportuar (33 të anketuara), ndërsa 37% (20 të anketuara) kanë raportuar zhvatjen.

Grafiku Q9_1. A keni raportuar përvojën me zhvatje të shërbimeve seksuale në vend që t'ju kenë kërkuar para/ryshfet si formë korrupsioni (në raste kur keni kërkuar një shërbim të caktuar publik)?




Nga gjithsej 28,9% ose 292 të anketuara që njohin dikë që është ballafaquar me zhvatje të shërbimeve seksuale, rreth një e treta e tyre (93 të anketuara) e dinë se viktimat ka raportuar veprën.

Grafiku Q9_2. A ka lajmëruar shoqja juaj përvojë me zhvatje të shërbimeve seksuale në vend që t'i kërkojnë para/ryshfet si forma korrupsioni (në raste kur keni kërkuar një shërbim të caktuar publik)?




Prirja për mosraportim të zhvatjes së shërbimeve seksuale, gjë që vërehet në përgjigjet e të anketuarave gradualisht pëson rënie kur u pyetën a do ta kishin raportuar rastin nëse në të ardhmen hipotetiki do t'u kishte ndodhur diçka e ngjashme. Kësaj pyetjeje i përgjigjeshin vetëm të anketuarat që më parë nuk kanë raportuar përvojë të deritanishme me zhvatje të shërbimeve seksuale. Nga gjithsej 95%, gjysma do të kishin marrë guximin ta raportojnë rastin, por brengos fakti që 15% e të anketuarave nuk do ta kishin ndarë këtë me askënd tjetër. Një e treta e të anketuarave kanë theksuar pamundësinë që të paramendojnë një situatë të tillë hipotetike për zhvatje të shërbimeve seksuale, të cilën do ta kishin raportuar.

Grafiku 10. Nëse diçka e ngjashme do t'ju kishte ndodhur juve personalisht, a do të kishit treguar/raportuar?



Nga gjysma e të anketuarave (529) të cilat do të kishin raportuar nëse në të ardhmen do të dëshmonin për zhvatje të shërbimeve seksuale, rreth dy të tretat prej tyre (340) rastin do ta lajmëronin në një institucion tjetër përkatës, jashtë vetë institucionit ku ka ndodhur ky rast. Rreth 28% e të anketuarave (146) rastin do ta kishin lajmëruar në institucionin ku ka ndodhur rasti, por 7,8% ose 41 të anketuara do ta kishin biseduar rastin vetëm në kuadër të familjes ose shoqes më të ngushtë.


Grafiku 11. Nëse do të kishit treguar/raportuar zhvatje të shërbimeve seksuale, kujt do t'i ishit drejtuar?



Policia është institucioni që përmendet më së shpeshti si institucion ku të anketuarat kanë thënë se do ta kishin raportuar rastin e zhvatjes së shërbimeve seksuale. Nga gjithsej 340 të anketuara, mbi 90% prej tyre kanë veçuar policinë si institucion ku do ta kishin lajmëruar rastin. Thujse për të gjitha që do ta kishin raportuar rastin, një nga institucionet e përzgjedhura do të ishte policia. Kjo pyetje kishte më shumë opsione përgjigjesh dhe rrjedhimisht një pjesë e të anketuarave kanë përmendur edhe institucione të tjera ku do ta kishin raportuar zhvatjen e shërbimeve seksuale.


Si institucion i dytë që përmendet është Qendra për Punë Sociale, pastaj Avokati i Popullit dhe organizatat joqeveritare.

Grafiku 12. Ku do të kishit raportuar zhvatje të shërbimeve seksuale? (pyetje me më shumë opsione përgjigjesh)



Siç edhe u tha më lart, stigmatizimi i shoqërisë, paragjykimet, etiketimi dhe tabutë dalin në sipërfaqe nëpërmjet përgjigjeve të të anketuarave që nuk do ta kishin raportuar zhvatjen e shërbimeve seksuale. Nga gjithsej 142 të anketuara, 40% ose 57 prej tyre, shprehin mosbesim ndaj sistemit me përgjigjen se raportimi nuk do të ketë asnjë efekt. Te 36% ose 51 e të anketuarave, do të kishte mbizotëruar turpi dhe gjykimi nga rrethi, për të cilat arsye nuk do të kishin raportuar, ndërsa te 20% ose 28 e të anketuarave nuk do të kishin raportuar nga frika se do të gjykohen se vetë janë fajtorë ose vetë kanë dhënë shkas për zhvatje të shërbimeve seksuale.

Grafiku 13. Pse nuk do të kishit raportuar zhvatje të shërbimeve seksuale?



Këto të dhëna tregojnë se shoqërisë sonë i duhet përkushtim në krijimin e politikave për të ndërtuar besimin në sistem.

Zgjidhja e pasojave që ngarkojnë jetën e viktimës së zhvatjes për shërbime seksuale, gjithsesi është edhe detyrim i shtetit.

6. GRATË NË POZITA UDHËHEQËSE

Në vendin tonë është i dukshëm ekzistimi i pabarazisë gjinore në pozicionimin e gruas në pozita udhëheqëse.

Përfshirja e grave dhe burrave në organet e vendimarrjes në vendin tonë është e rregulluar me ligj. Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave² përmban dispozita për pjesëmarrjen e burrave dhe grave në komisione dhe këshilla drejtues, gjegjësisht në organet vendimarrëse, që në nivel nacional dhe lokal nuk duhet të jetë më pak se 40%. Kodi Zgjedhor, ndërkaq, parasheh masë afirmative me të cilën mundësohet pjesëmarrje e të dy gjinive në këshilla komunale (dispozita e njëjtë vlen edhe për zgjedhjen e deputetëve), respektivisht me këtë dispozitë garantohet se të dy gjinitë në këshillat komunale do të përfaqësohen me së paku 30%³.


Ndërlidhja e nivelit të korrupsionit në vend me emërimin e grave në pozita udhëheqëse paraqet temë interesi në kuadër të pyetjeve në vazhdim. Mbi gjysma e të anketuarave (53,5%) konsiderojnë se niveli i korrupsionit në vend do të ishte zvogëluar nëse zgjedhen/emërohen më shumë gra në pozita më të larta udhëheqëse. Këto të anketuara janë kryesisht me arsim të lartë, kanë të ardhura më të larta mujore dhe i përkasin grupmoshës 35–44 vjeç.

Rreth një e katërta e të anketuarave nivelin e korrupsionit në vend nuk e lidhin aspak me emërimin në pozita më të larta udhëheqëse të grave. Këto të anketuara janë kryesisht me arsim fillor dhe amvisë.

² <https://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/ZEM%205%2009%202011%20L.pdf>

³ https://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/informacija%20za%20analiza_lokalna%20samouprava.pdf

Grafiku 14. A mendoni se niveli i korrupsionit në vend do të ishte zvogëluar nëse më shumë gra zgjidhen/emërohen në pozita më të larta udhëheqëse?




7. DALLIMI I FORMAVE SPECIFIKE TË KORRUPSIONIT

Numri më i madh i të anketuarave konsiderojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale si formë specifike e korrupsionit nuk është e njohur dhe nuk dallohet mjaftueshëm në opinionin publik – në diskutime, në politikat dhe aktet ligjore në vendin tonë. Të dhënat e mbledhura “pak” ose “aspak” (nuk dihet për këtë temë) paraqesin mbi 70% të përgjigjeve të të anketuarave, që paraqet sinjal të qartë se duhet të gjenden mekanizma për avancim të diskutimit, ndjekje të gjendjes dhe informim i opinionit publik për temat që kanë të bëjnë me zhvatjen e shërbimeve seksuale. Përgjigjet e një së katërtës së të anketuarave që konsiderojnë se nuk dihet fare për zhvatjen seksuale si formë korrupsioni në këtë vend, tregon se aspektet gjinore të korrupsionit nuk njihen në publik.

Rreth një e pesta e të anketuarave që konsiderojnë se zhvatja seksuale si formë korrupsioni njihet dhe dallohet mjaftueshëm në publik, kryesisht janë të anketuara me arsim të lartë dhe të punësuar në sektorin publik.

Grafiku 15. A mendoni se format specifike të korrupsionit siç është zhvatja seksuale për të siguruar shërbime publike njihet dhe dallohet mjaftueshëm në publik – në diskutime, në politika, akte ligjore në vendin tonë?




Në shtojcë paraqiten deklaratat e të anketuarave lidhur me aktivitetet konkrete për luftë kundër zhvatjes seksuale si formë korrupsioni.

Nga të gjitha situatat e ofruara, të anketuarat më së shumti pajtohen për t'i dhënë mbështetje koleges e cila do të kishte raportuar shërbim seksual nga eprori i përbashkët. Mbi 73% pajtohen me këtë deklaratë dhe ato kryesisht janë të anketuara me arsim të lartë dhe të punësuar në sektorin publik.

Peticionin kundër zhvatjes seksuale si formë korrupsioni do ta kishin nënshkruar dy të tretat e të anketuarave, por mendimin e tyre kundër zhvatjes seksuale publikisht në rrjete sociale do ta kishin shprehur rreth gjysma e të anketuarave.

Në protesta kundër zhvatjes seksuale si formë korrupsioni do të kishin marrë pjesë 56% e të anketuarave. Këto kryesisht janë të anketuara në moshë më të re, maqedonase dhe studente.

Grafiku 16. A pajtoheni apo nuk pajtoheni me gjitha deklaratat më poshtë?



GJETJET KRYESORE

Në të tri fushat e ofruara, të anketuarat më së shpeshti perceptojnë korrupsionin si problem të madh.

- ▲ Në **jetën e tyre të përditshme**, 38% kanë theksuar se korrupsioni është problem i madh, 31% janë shprehur se është problem i vogël, ndërsa për 28% të të anketuarave korrupsioni aspak nuk paraqet problem në jetën e tyre të përditshme.
- ▲ Në **komonën** ku jetojnë, mbi gjysma (51%) e të anketuarave theksojnë se është problem i madh, rreth një e treta (32%) se është problem i vogël, ndërsa vetëm 8% theksojnë se në komonën e tyre korrupsioni nuk paraqet problem fare.
- ▲ Se korrupsioni paraqet problem të madh në **vendin tonë**, pajtohen shtatë nga dhjetë të anketuara (77%).
- ▲ Rreth dy të tretat e të anketuarave kanë theksuar se nuk bëjnë dallimin e aspekteve gjinore të korrupsionit, gjegjësisht se burrat dhe gratë **kanë tendencë korrupsioni** në mënyrë të njëjtë. Rreth 15% konsiderojnë se te gratë tendenca ndaj korrupsionit është më e vogël se sa te burrat, ndërsa 18% mendojnë të kundërtën, se gratë kanë tendencë më të theksuar ndaj korrupsionit në raport me burrat.
- ▲ Se korrupsioni **ndikon** në mënyrë të njëjtë edhe te gratë edhe te burrat pajtohen gjashtë nga dhjetë të anketuarat. Një e pesta e të anketuarave mendojnë se korrupsioni më shumë ndikon te gratë, e po aq mendojnë se më shumë ndikon te burrat.
- ▲ Zhvatjen e shërbimeve seksuale nga ana e të punësuarve në sektorin publik, në shkëmbim të dhënies së një shërbimi publik si **formë** korrupsioni, e njohin 78% e të anketuarave. Vetëm një nga dhjetë të anketuarat konsideron se zhvatja e shërbimeve seksuale nga ana e të punësuarve në sektorin publik në shkëmbim të dhënies së një shërbimi publik **nuk paraqet formë** korrupsioni, ndërsa 12% kanë shprehur pamundësinë të dallojnë korrupsion në zhvatjen e shërbimeve seksuale.
- ▲ Rreth 59% e të anketuarave konsiderojnë se bartësit e funksioneve dhe kompetencave publike në pushtet **ndodh të kërkojnë** shërbime seksuale në vend të parave/ryshfetit, në shkëmbim të dhënies së shërbimit publik për të cilin janë kompetent. Nga këto, 21.5% kanë theksuar se kjo ndodh shpeshherë.
- ▲ Dy të tretat e të anketuarave mendojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale në shkëmbim të dhënies së një shërbimi publik ndodh **edhe në sektorin publik, edhe në sektorin privat**.

- ▲ **Administrata shtetërore** (në nivel qendror dhe lokal) është institucioni ku të anketuarat mendojnë se më së shpeshti ndodh zhvatje seksuale si formë korrupsioni. Përgjigjet e mbledhura “shpeshherë” dhe “ndonjëherë” përbëjnë dy të tretat e të anketuarave në RMV që detektojnë keqpërdorim të funksionit ose kompetencave publike, me qëllim të sigurimit të shërbimeve seksuale në administratën shtetërore.
- ▲ Punësimi (27%) dhe avancimi në vend pune (26%) janë **situatat më të shpeshta** ku personat e pushtetshëm kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të dhënies së shërbimit publik për të cilin janë kompetent.
- ▲ Mbi 63% e të anketuarave nuk raportojnë **përvojë personale ose të huaj** lidhur me këtë formë korrupsioni. Një e katërta e të anketuarave kanë theksuar se **nuk kanë pasur përvojë personale, por njohin dikë** që ka kaluar këtë formë korrupsioni dhe 5.4% e të anketuarave që **personalisht** kanë përjetuar zhvatje të shërbimeve seksuale. Nga këto 54 të anketuara (5.4%), vetëm 20 kanë shprehur gatishmërinë që ta **raportojnë** këtë presion dhe të ballafaqohen me sfidën për zbulimin e kësaj përvoje (37%).
- ▲ **Policia** është institucioni ku të anketuarat më së shpeshti kanë përmendur se do ta kishin raportuar rastin e zhvatjes së shërbimeve seksuale. Nga gjithsej 340 të anketuara, mbi 90% e tyre kanë cekur policinë si institucion ku do ta kishin raportuar rastin.
- ▲ Mbi gjysma e të anketuarave (53.5%) mendojnë se **niveli i korrupsionit** në vend do të zvogëlohej nëse më shumë gra zgjidhen/emërohen në pozita më të larta udhëheqëse.
- ▲ Mbi 70% e përgjigjeve (të dhënat e mbledhura “pak” ose “aspak”) të të anketuarave mendojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale si formë specifike korrupsioni **nuk është e njohur dhe nuk dallohet mjaftueshëm** në publik – në diskutime, në politikat dhe aktet ligjore në vendin tonë.
- ▲ Mbi 73% e të anketuarave do të kishin **mbështetur një kolege** që do të kishte raportuar insistimin për shërbim seksual nga eprori i përbashkët.
- ▲ **Peticionin** kundër zhvatjes seksuale si formë korrupsioni do ta kishin nënshkruar dy të tretat e të anketuarave, por **mendimin e tyre** kundër zhvatjes seksuale në rrjete sociale haptas do ta kishin thënë rreth gjysma e të anketuarave.
- ▲ Në **protestë** kundër zhvatjes seksuale si formë korrupsioni, do të kishin marrë pjesë 56% e të anketuarave.

RAPORT

I HULUMTIMIT CILËSOR PËR PERCEPTIMIN E FORMAVE GJINORE TË KORRUPSIONIT NË MAQEDONINË E VERIUT



1. KONSTATIMET KRYESORE NGA HULUMTIMI

Fokusi i këtij studimi cilësor ishte fitimi i një pasqyre më të thellë në perceptimin e grave për gjendjet me format gjinore të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Analiza e të dy diskutimeve në grup tregon se të gjitha pjesëmarrëset njohin se korrupsioni është i pranishëm në gjithë shoqërinë tonë, por është veçanërisht i dukshëm në institucionet shtetërore. Sjellja e korruptuar është aq e rrënjosur në jetën e përditshme, sa që tashmë bëhet një mënyrë e pranueshme dhe e zakonshme e sjelljes dhe e kryerjes së gjërave. Pjesa më e madhe e pjesëmarrëseve konsiderojnë se gjinia nuk përcakton nënshttrimin ndaj korrupsionit dhe se gratë dhe burrat janë njësoj të nënshttruar ndaj korrupsionit. Së këndejmi, ata nuk besojnë se niveli i korrupsionit do të zvogëlohet nëse më shumë gra vendosen në poste udhëheqëse.

Të gjitha pjesëmarrëset në këtë hulumtim cilësor zhvatjen e shërbimeve seksuale si zëvendësim për ofrimin e shërbimit publik e konsiderojnë korrupsion, me ç'rast ato potencojnë se bëhet fjalë për formën më të keqe të korrupsionit.

Të gjitha pjesëmarrëset konsiderojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale është dukuri e shpeshtë në shoqërinë tonë, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat dhe se shpesh kërkohet për punësim, avancim në vendin e punës, për kryerje të ndonjë shërbimi i cili është me rëndësi të madhe për gruan viktimë, si dhe në arsimin e lartë për dhënie të ndonjë provimi të caktuar. Megjithatë, përshtypje dominuese e të gjitha pjesëmarrësve është se gratë heshtin dhe shumica dërmuese e tyre nuk e paraqesin rastin.

Të gjitha pjesëmarrëset konsiderojnë se korrupsioni gjinor nuk është mjaft i njohur në publik dhe nuk është prezent si temë në politikat dhe në rregullat ligjore në vendin tonë. Ashtu siç heshtin për to viktimat, ashtu hesht edhe shoqëria. Ato konsiderojnë se për të ngritur vetëdijen dhe edukimin e qytetarëve për korrupsion gjinor, nevojitet një qasje sistemore thelbësore dhe të organizuar në të cilën do të marrin pjesë të gjitha institucionet e interesuar në shoqërinë. Fushatat e shpejta mediatike kanë efekt sipërfaqësor dhe të shkurtër dhe si të tilla ato nuk mjaftojnë për të bërë ndryshime të dukshme as te vetëdija e qytetarëve, as në punën e institucioneve kur bëhet fjalë për këtë problem.

Asnjëra prej pjesëmarrësve, pa dallim nëse e ka përjetuar personalisht korrupsionin gjinor ose njih ndonjë grua e cila ka pasur eksperiencë të tillë, nuk do ta kishte zgjedhur rrugën institucionale për ta zgjidhur këtë problem. Shkaku kryesor për atë është mosbesimi i fuqishëm në institucionet dhe bindja se drejtësia asnjëherë nuk do të realizohet.

Përveç mosbesimit në institucionet, si një prej barrierave kryesore për zbardhjen e guximshme dhe publike të rasteve të korrupsionit gjinor theksohet stigmatizimi i fuqishëm që e shoqëron gruan në shoqërinë tonë dhe tendenca që përgjegjësia t'i hidhet gruas, me ç'rast cenohet autoriteti dhe integriteti i saj në mjedisin. Në këtë mënyrë, gruaja nuk është vetëm viktimë e korrupsionit gjinor, por ajo duke folur publikisht bëhet viktimë ende më e madhe e sistemit dhe shoqërisë e cila pa bazë e shpall fajtores.

Të gjitha pjesëmarrëset konsiderojnë se këtij problemi doemos duhet t'i qasemi përmes ndryshimeve serioze sistemore dhe institucionale. Në këtë drejtim ato theksojnë se institucionet shtetërore kompetente dhe ministrinë (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Drejtësisë, Komisioni i për Parandalimin e Korrupsionit, gjykatat, policia etj) doemos duhet të funksionojnë, ta punojnë punën drejt, t'i zbatojnë ligjet me qëllim për ta kthyer besimin e humbur të qytetarëve në punën e tyre profesionale. Gjithashtu, pjesëmarrëset potencojnë se vetëdija e qytetarëve për këtë problem do të rritet dhe besimi në institucionet do të përforcohet nëse ekzistojnë dënime serioze për autorët e llojit të tillë të veprave, pa marrë parasysh fuqinë e tyre që e posedojnë momentalisht dhe nëse për to flitet hapur në media.

Njëkohësisht, pjesëmarrëset e potencojnë mbrojtjen e pamjaftueshme juridike e gruas viktimë e korrupsionit gjinor. Së këndejmi lind edhe domosdoshmëria për ndryshimin e ligjeve në lidhje me këtë formë të keqpërdorimit të fuqisë nga bartësit e funksioneve publike.

Vetëm në këtë mënyrë, shumica e grave viktimë do të inkurajohen të flasin publikisht dhe ta paraqesin rastin, gjë që do të kontribuojë për uljen e korrupsionit gjinor në vendin tonë.

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Me qëllim për të pasur një pasqyrë më të thellë të rezultateve të fituara nga hulumtimi reprezentativ kombëtar për gjendjet me format gjinore të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut të realizuar në periudhën nga 02.06.2021 deri më 09.06.2021 në një mostër reprezentative prej 1013 të anketuarve në moshë 18 vjeçare dhe më të vjetër që jetojnë në territorin e RMV-së, u realizua një hulumtim cilësor plotësues prej dy diskutimesh grupore.

Në këtë hulumtim cilësor morën pjesë gjithsej 15 gra nga 8 rajone të ndryshme të shtetit tonë, të cilat ose kanë përjetuar vetë korrupsionin gjinor ose njohin person që ka pasur përvojë të tillë dhe kishin mundësi për të dëshmuar përvojën e tyre.

Grupet ishin të balancuara në lidhje me kombësinë, moshën, arsimin, si dhe statusin e punës (sektori publik/privat).

Gjatë procesit të rekrutimit, të gjithë pjesëmarrëset morën sqarim për natyrën dhe qëllimet e studimit me qëllim për të pasur një pasqyrë të qartë për temën që do të jetë lëndë e diskutimit, si dhe për pritjet nga to. Të gjithë pjesëmarrësve u ishte garantuar anonimiteti dhe mbrojtja e informatave personale.

Grupet u mbajtën përmes aplikacionit Zoom, në periudhën 21– 22. 09.2021.

Konstatimet nga ky studim cilësor duhet të merren parasysh vetëm si indikatorë për pikëpamjet dhe sjelljen e grave pjesëmarrëse në këto diskutime grupore dhe ato nuk duhet të pranohen në mënyrë të pakushtëzuar si mostër përfaqësuese për pikëpamjen e të gjitha grave banore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN NË VEND

3.1 ASOCIACIONE SPONTANE PËR KORRUPSION

Asociacione spontane më të shpeshta për nocionin “korrupsion” te të anketuarit në të dyja diskutimet grupore ishin si më poshtë:

- ▲ Zhvatja e parave
- ▲ Shërbim për shërbim
- ▲ Keqpërdorimi i pozitës
- ▲ Pushteti, forca
- ▲ Ryshfeti
- ▲ Politika
- ▲ Institucionet shtetërore

Te pjesa më e madhe e pjesëmarrëseve kuptimi i nocionit “korrupsion” shkakton ndjenjë të shqetësimit dhe paretisë.

3.2 KU ËSHTË MË I PRANISHËM KORRUPSIONI?

Analiza e diskutimit grupor tregon se sipas grave pjesëmarrëse korrupsioni është i pranishëm në gjithë shoqërinë tonë, por është veçanërisht i dukshëm në institucionet shtetërore. Është për t'u theksuar mendimi se korrupsioni është rrënjësuar thellësisht në mendësinë e popullit tonë, sipas pjesës më të madhe të pjesëmarrëseve ai është mënyrë e pranuar shoqërisht dhe në shumë situata përbën “mënyrë të vetme ose më të shpejtë të kryerjes së punëve.”

Është i pranishëm pothuajse gjithandej, edhe institucionet shtetërore edhe ato publike janë vërtetë të korruptuar. Jo vetëm shëndetësia, por edhe arsimin e kemi të korruptuar. Pothuajse në të gjitha institucionet nëse duam të kryejmë punë më shpejtë duhet doemos në njëfarë mënyrë “t’ia lyejmë dorën dikujt (t’i japim ryshfet)”. Dhe kjo tanimë është bërë praktikë edhe në sektorin privat. Por në sektorin shtetëror është shumë e shprehur. Grua, 25 vjeçare, maqedonase.

Sikur është gjë e natyrshme, sikur e kemi në gjenetikë. Nëse nuk i nënshtroesh korrupsionit si individ, ose nëse nuk shërbehesh me metoda të vogla të korrupsionit, me sa duket mbetesh budallai i fundit dhe nuk mund të përparosh ose t'i kryesh punët assesi. Grua, 36 vjeçare, maqedonase.

Mendoj se shoqëria jonë, përkatësisht vendi ynë, veçanërisht Ballkani është shoqëri e korruptuar. Korrupsioni është i pranishëm gjithandej. Ne jo vetëm që japim ryshfet, por edhe pranojmë ryshfet. Qoftë 100 gramë kafe, ose darkë... për çfarëdo arsye, për të kryer punë më shpejtë në klinikë, ose çfarëdo qoftë pune tjetër... Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

3.3 NËNSHTRIMI NDAJ KORRUPSIONIT

Numër më i vogël i pjesëmarrëseve në këtë hulumtim cilësor konsiderojnë se burrat janë më të korruptuar se gratë sepse shumica e burrave janë në pozita udhëheqëse, posedojnë pushtet më të madh dhe së këndejmi janë edhe më të nënshtuar ndaj veprimeve korruptive. Nga ana tjetër gruaja përshkruhet si më e ndjeshme, më e butë dhe më e moralshme në krahasim me burrat.

Unë do të them se nuk jemi të barabartë këtu. Te ne më të korruptuar janë burrat, sepse mendoj se në shoqërinë tonë janë më shumë në funksione më të larta dhe me vetë fuqinë që mbartin ato funksione të larta, ata janë më të nënshtuar ndaj veprimeve të tilla. Grua, 28 vjeçare, maqedonase.

Unë mendoj se gratë janë më pak të korruptuara dhe janë pak më të vëmendshme, kanë sens për gjërat, gratë janë më të buta dhe më të ndjeshme. Gruaja, kur dikush do të dojë që ta qerasë diçka me vëmendje të vogël, ndihet menjëherë e korruptuar, ndërsa te burrat kjo shkon shumë më lehtë. Grua, 24 vjeçare, maqedonase.

Megjithatë, pjesa më e madhe e pjesëmarrëseve konsiderojnë se gjinia nuk luan rol të konsiderueshëm në nënshttrimin ndaj korrupsionit dhe se gratë, sikurse burrat, janë të nënshtuara barazisht ndaj korrupsionit. Prandaj, ato nuk besojnë se niveli i korrupsionit do të zvogëlohet nëse vendosen më shumë gra në pozitat udhëheqëse.

Vetë pozita i ndryshon njerëzit. Qoftë burra apo gra, kjo nuk përbën shumë dallim. Bile edhe gruaja kur vjen në pozitë më të lartë, duke dashur të dëshmohej se është më e mirë se burrat – mund të bëhet më e keqe. Mendoj se kjo nuk ka të bëjë me gjininë. Të gjithë e dimë se si duhet vepruar dhe si nuk duhet, por kur vijmë në pozitë me pushtet, nuk vlejnë më rregullat e njëjta. Siç thonë: "Jepi 5 minuta

pushtet dhe do ta shihni çfarë njeriu është.” Për shkak të nevojës së gruas për t’u dëshmuar, ajo bëhet më e keqe. Grua, 45 vjeçare, maqedonase.

Sipas meje, gjinia definitivisht nuk luan rol në sjelljen korruptive. Nga gjithë gjërat në botë vetëm interesi është i përjetshëm. Dhe kur merr pozitë pushteti dhe parash, gjinia nuk do të luajë kurrfarë roli, së paku sipas meje. Gratë janë gjithashtu të nënshtruara ndaj korrupsionit njësoj si burrat, e vetmja arsye që i pengon në shoqërinë tonë është se shumica e tyre nuk janë ende në funksione të larta për dallim nga burrat, prandaj nuk kanë ardhur në shprehje. Unë besoj se nuk do të ketë kurrfarë dallimi, nuk do të çrrënjoset korrupsioni nëse vijnë vetëm gra në pozicione udhëheqëse. Mund të jetë njësoj, por edhe më keq. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Është për t’u theksuar fakti që një pjesë e dukshme e pjesëmarrëseve konsiderojnë se gruaja kur vjen në pozitë udhëheqëse dhe disponon fuqi më të madhe, mund të jetë bile “edhe më e keqe” se burri si reagim i ndjenjave shumëvjeçare të presionit, pabarazisë dhe privimit nga e drejta.

Unë, në asnjë mënyrë, nuk mendoj se gratë janë më të mira se meshkujt, bile janë edhe më të këqija. Përkatësisht, ato që janë të shtypura për kohë të gjatë, ato jetojnë në botën për ta treguar dhe dëshmuar veten. Duan të hakmerren. Mendimi im është se në përgjithësi gratë janë shumë më egoiste dhe më të këqija se burrat. Grua, 44 vjeçare, maqedonase.

Unë mendoj se në një të ardhme të afërt gratë i marrin cilësitë e meshkujve. Edhe ato që janë në pozitë, si drejtore, funksione të larta, mburren më shumë se meshkujt. Ja edhe unë jam e punësuar dhe momentalisht eprorja ime është grua, megjithatë them më mirë do të ishte të jetë eprori burrë. Pra, me burrë do të merresh vesh më lehtë sesa me grua. Ne gratë, gjithnjë e më shumë, bëhemi më egoiste. I kopjojmë burrat në shumë cilësi. Dhe duam të jemi më dominuese. Grua, 53 vjeçare, maqedonase.

4. PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT GJINOR NË VEND

Të gjithë pjesëmarrëset në këtë hulumtim cilësor zhvatjen e shërbimit seksual si zëvendësim për ofrimin e shërbimit publik e konsiderojnë korrupsion. Disa prej tyre theksuan se bëhet fjalë për formën më të keqe të korrupsionit, ndërsa për një pjesë e tyre kjo është më shumë se korrupsion – e definojnë si ‘mobing’ serioz dhe abuzim seksual që lë pasoja psikologjike serioze mbi personin. Zhvatja seksuale e vë gruan në rolin e viktimës dhe krijon një spektër të plotë të emocioneve komplekse siç janë: frika për ekzistencë nga njëra anë dhe faji dhe turpi nga gjykimi i rrethinës nga ana tjetër.

Kjo është më shumë se korrupsion. Mendoj se më lehtë përballohet të kërkosh para sesa shërbim seksual. Dhe zakonisht ky veprim shkon rrallë drejtpërdrejt, por këto janë sinjale të tërthorta të cilat janë shumë të dukshme. Grua, 40 vjeçare, shqiptare.

Unë pajtohem dhe sipas meje është forma më e rëndë e korrupsionit. Vetëm se momenti për ta paraqitur rastin është i rëndë. Bile edhe një pjesë e madhe e popullatës nuk e definojnë si korrupsion, por më shumë si një formë e “shërbimit për shërbim”. Dhe një pjesë e madhe e grave atë e heshtin, nuk e tregojnë. Dhe disi vijmë deri te një rreth magjik i cili rrotullohet tërë kohën. Grua, 24 vjeçare, maqedonase.

Unë e shoh atë si korrupsion. Nëse gruaja refuzon në cilëndo formë, atëherë ka frikë për vendin e punës, ka frikë nga institucioni dhe nga rrethina që e rrethon, që ta mos e përgojnë... dhe kështu gjithë ajo bëhet fshehurazi dhe rrethi i njerëzve që mund të kuptojnë dhe të dinë në të vërtetë se çfarë ka ndodhur është i vogël... Unë këtë e konsideroj edhe si korrupsion edhe si ‘mobing’. Grua, 53 vjeçare, maqedonase.

Të gjithë pjesëmarrëset konsiderojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale është e shpeshtë në shoqërinë tonë, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat. Përshtypja e tyre personale për shpeshimin e kësaj dukurie lind shpesh nga informatat e marra nga miqtë e tyre të afërt ose fafiset e tyre që janë përballur personalisht me përvojën e korrupsionit gjinor. Zhvatja seksuale shpesh kërkohet si zëvendësim për punësim, avancim në vendin e punës, kryerje të ndonjë shërbimi i cili është me rëndësi të madhe për gruan viktimë, si dhe në arsimin e lartë për dhënie të ndonjë provimi apo punimit të diplomës. Megjithatë, përshtypje dominuese e të gjithë pjesëmarrëseve është se gratë heshtin dhe përqindja më e madhe e tyre nuk e paraqesin rastin aspak. Një pjesë e vogël e pjesëmarrëseve në diskutim mblodhën guximin për të pranuar se edhe vetë e kanë përjetuar këtë përvojë, si dhe për ta ndarë atë me të tjerët në grupin.

Kam dëgjuar në rrethinën time. Unë kam qenë iniciatore që ta thotë atë, por nuk ka dashur ta shpreh. Për arsye të thjeshtë sepse nuk ka pasur besim ndaj institucioneve. As nuk janë të mbrojtura, as që do të dëshmohet vepra. Kot që do të mundohen pesë vite. Grua, 44 vjeçare, maqedonase.

Është i pranishëm. Edhe unë kam dëgjuar dëshmi nga gra të afërta. Dhe hapni cilindro forum anonim... njerëzit atje nuk ka arsye për të shpikur dhe gënjyer. Atje do të lexoni shumë gjëra të neveritshme. Mund të them se ka pasur edhe shembuj në kohën kur kam qenë studente. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Pa marrë parasysh qytetin, fshatin, kudo që të jesh, kjo është pasqyra e përgjithshme – gjithandej është e pranishme, por nuk flitet për këtë. Grua, 38 vjeçare, maqedonase.

Unë mendoj se është dukuri e shpeshtë, por nuk është publike. Gruaja hesht nga turpi. Grua, 34 vjeçare, shqiptare.

Të gjithë pjesëmarrëset konsiderojnë se korrupsioni gjinor nuk është mjaft i njohur në publik dhe se për të nuk flitet në debate dhe diskutime në mediat.

Njëkohësisht ato konsiderojnë se korrupsioni gjinor nuk është i pranishëm si temë në politikat dhe në rregullat ligjore në vendin tonë. Siç heshtin për të viktimat, ashtu hesht edhe shoqëria. Për disa pjesëmarrëse, fushatat e shpejta nuk mjaftojnë për të bërë ndryshime të dukshme as në vetëdijen e qytetarëve, as në punën e institucioneve kur bëhet fjalë për këtë problem.

Nuk është aspak e pranishme kjo temë. Nuk flitet mjaftueshëm. Bile edhe atëherë kur flitet, unë e përjetoj personalisht sikur vetëm të kalojë, të shohin tjerët sa jemi pro-evropianë... Unë këtë më shumë e përjetoj si formalitet. Shumë e rrejshme, shumë e tejdukshme, e lirë, plastike. Nuk ka kurrfarë kuptimi. Nuk jep asnjëfarë rezultati. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Ende jemi prapa me këtë temë. Unë mendoj se aspak nuk flitet për këtë në publik. Si e para, çdo femër do të turpërohet të paraqesë rastin, si e dyta, do ta gjykojnë menjëherë, askush nuk do ta kuptojë. Si e treta, do të humbë procesi diku, dhe do të shpëtojë ai që e ka bërë atë. Grua, 48 vjeçare, maqedonase.

Unë vetëm dua të them, a pyetët a është aktuale. Po, është aktuale në shoqërinë, por në mediat nuk është. Unë nuk kam hasur informata, veçanërisht për korrupsion seksual nuk kam hasur. Grua, 22 vjeçare, maqedonase.

4.1 MËNYRA TË NGRITJES SË VETËDIJES DHE EDUKIMIT TË PUBLIKUT PËR KORRUPSIONIN GJINOR

Pjesëmarrëset konsiderojnë se është e domosdoshme fushatë mediatike intensive në të cilën do të përfshihen më shumë segmente, si institucionet shtetërore ashtu edhe mediat dhe sektori joqeveritar. Në kuadër të kësaj fushate, përveç pjesës edukative dhe ngritjes së vetëdijes për korrupsion gjinor, është e domosdoshme të aktivohen edhe qendrat e mbështetjes në të cilat mund të drejtohet gruaja dhe të marrë ndihmë juridike falas si dhe udhëzime të qarta për atë se ku mund ta paraqesë rastin.

Unë mendoj se duhet të jetë fushatë në nivel kombëtar. Jo të përfshihet vetëm një ose dy ministri. Unë mendoj se kjo duhet të jetë në nivel kombëtar sepse duhet të ndryshohen disa punë në shoqërinë. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Drejtësisë, Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit... fushatë kombëtare, e cila do të jetë me trajnime, me reklama, me informim, me qendra për mbështetje, me qendra të cilat do të ofrojnë shërbime juridike falas – nuk mundet që çdokush të lejojë konsultim me avokat. Edhe qendrat të cilat do t'ju udhëzojnë në institucionet juridike, ku duhet të ankoheni. Por para së gjithash, t'i kushtohet vëmendje vetëdijes. Çfarë është korrupsioni ose keqpërdorimi – Gjithçka që të bën ty të mos ndjehesh mirë! Grua, 40 vjeçare, shqiptare.

Mendoj se edhe mediat duhet të përfshihen. Unë paramendoj ndonjë logo me shenjën STOP korrupsionit gjinor. Dhe të informohen gratë ku të drejtohen në rast se u ndodh kjo atyre. Grua, 34 vjeçare, shqiptare.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Siç ka gjithçka tjetër, siç ka “Vaksinohu!” le të ketë edhe për këtë. Për shembull – Paraqit keqpërdorim seksual” Edhe kjo të imponohet, të detyrohet, t'u ndihmohet atyre grave që mundohen, që nuk kanë ku të drejtohen. Grua, 48 vjeçare, maqedonase.

Po, kishte një emision kroat ose serb. Figura e gruas ishte e mbrojtur, nuk dukej, ndërsa rrëfente gjithçka: si ka kaluar, çka ka përjetuar, çfarë ka bërë. Prandaj mendoj se mediat duhet të jenë më të zëshme për këtë çështje. Dhe gratë të shfaqen guximshëm. Grua, 53 vjeçare, maqedonase.

Edhe në të dyja diskutimet grupore pjesëmarrëset e theksuan nevojën për edukim të hershëm të të rinjve për barazinë gjinore, çfarë është sjellje korruptive dhe demistifikim i fjalës “viktimë”, me qëllim të heqjes së fajit dhe turpit që imponohet te personi i cili do të gjendet në situatë të tillë.

Kur tanimë flasim në nivel institucional, unë do ta përfshij edhe procesin arsimor, fëmijët mund të arsimohen që nga vegjëlja për barazinë gjinore. Sa më shumë që i arsimoni, sa më shumë që i mësoni se gratë dhe burrat janë të barabartë në shoqëri, aq më tepër do të krijohen gjenerata racionale, të cilat në të ardhmen nuk do ta përsërisin atë sjellje siç e bëjnë atë sot ato gjenerata tjera toksike. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Ndoshta duhet shumë më herët. Ja në arsim bëhen edukime të shumtë dhe ligjërime në çfarëdo tema. Ndoshta edhe këtu duhet të fillohet nga arsimi. Të edukohet çdo vajzë e re grua e ardhshme, që të dinë të mbrohen. T'i njohin të drejtat e tyre. Të dinë se ka mënyrë për të shpëtuar. Që nga vegjëlja të jenë të përgatitur se në botën e të rriturve mund t'u ndodhë diçka e tillë dhe se nuk kanë pse të frikohen. Grua, 48 vjeçare, maqedonase.

Dhe t'i edukojmë bijat, të jenë të zëshme, të shprehen, të luftojnë për të drejtat e tyre. Të mos kenë frikë nga askush. Grua, 49 vjeçare, maqedonase.

5. PËRVOJAT LIDHUR ME KORRUPSIONIN GJINOR DHE MËNYRËN E REAGIMIT

Në këtë hulumtim cilësor u përfshinë pjesëmarrëse, të cilat ose kanë pasur personalisht përvojë lidhur me korrupsionin gjinor, ose ndonjë person të afërt që ka pasur përvojë të tillë dhe mund të dëshmojnë për të njëjtën.

Te të gjitha pjesëmarrëset, pa marrë parasysh nëse e kanë përjetuar personalisht ose njohin ndonjë grua që kanë pasur përvojë të tillë, ndjehej një nivel i lartë i revoltës dhe shqetësimit përderisa flisnin për këtë temë. Megjithatë, **asnjëra prej tyre nuk do ta kishte zgjidhur rrugën institucionale për zgjidhjen e këtij problemi**. Disa prej pjesëmarrëseve cekën shembuj personalë të korrupsionit gjinor lidhur me asistentë dhe profesorë të fakultetit të cilët me dekada kanë sjellje korruptive, megjithëse disa studentë i paraqesin veprimet e tilla, ato ende janë në vendet e tyre të punës dhe nuk pësojnë kurrfarë pasojash juridike.

Kam frikë nga ajo që nuk kemi shtet të së drejtës. Nëse flasim se asistenti im i dikurshëm është profesor i një nxënëse tjetër në grupin, dhe nëse përmbledhim se 20 vite ai e bën këtë vepër, çfarë të pres më unë nga ky shtet? S'kam qenë e vetmja?! Edhe sikur të më ndodhë, do të kem guxim, do të dal të them nuk më intereson se kush çfarë flet për mua, unë nuk i besoj shtetit të së drejtës, se kjo do të shkojë deri në fund. Kjo është frika. Frika ime. Grua, 40 vjeçare, shqiptare.

Nuk e bëjnë punën e tyre institucionet. Askush nuk dëshiron të maltretohet. Unë personalisht nuk do të kisha paraqitur, jo se kam frikë nga gjykimi, por nuk dua të maltretohem. Më mirë do të kisha publikuar në të gjitha rrjetet sociale. Se do të zgjidhet – nuk do të zgjidhet. Me sa duket edhe institucioneve u konvenojnë njerëz të tilla që të shëtisin në shoqërinë. Grua, 44 vjeçare, maqedonase.

Unë pajtohem, por jo se nuk ka grua e cila do ta çojë punën deri në fund, ndoshta do të gjendet ndonjë e guximshme dhe do ta çojë punën deri në fund, por unë nuk i besoj gjyqësorit sepse konsideroj se edhe ato janë të korruptuar. Pse ta çoj unë punën deri në fund, nëse gjykata nuk më mbron? Grua, 22 vjeçare, maqedonase.

Askush nuk ka besim në institucionet. Edhe po të mbledh guximin, nëse më ndodh diçka e tillë, nuk më intereson çfarë do të thotë rrethina, vetëm do të maltretohem nëpër gjykata. Asnjëherë nuk do të ketë zgjidhje gjyqësore. Lige ka te ne, por nuk funksionojnë. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Shumica e tyre theksuan se për përvojën do të bisedonin me anëtarët e familjes dhe bashkë do të vendosin cili do të jetë hapi i radhës. Disa theksuan se do të konsultohen me avokat.

Edhe unë do ta kisha ndarë në shtëpi me bashkëshortin. Dhe do të kisha bërë një plan. Nuk do ta kisha paraqitur rastin sepse nuk besoj që institucionet do të zgjidhin diçka. Do të zvarritem me vite dhe nuk do të zgjidhet asgjë. Në fund vetëm unë do të dëmtohem në aspektin financiar, psikik, mendor. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Njëkohësisht një pjesë e pjesëmarrëseve theksuan se edhe po të duan të paraqesin ato nuk e dinë se cili institucion është kompetent dhe kujt duhet t'i drejtohen.

Unë fillimisht nuk di ku të drejtohem, në cilin institucion. A është policia, a duhet unë të kërkoj avokat, çfarë avokati... mendoj se ky është problem i përgjithshëm që njerëzit nuk dinë ku të drejtohem. Grua, 38 vjeçare, maqedonase.

Unë sinqerisht nuk di, çuditë, njëjtë si bashkëbiseduesja paraprahe, nuk di ku të drejtohem. Vërtet, nuk di, jam plotësisht e painformuar. Përndryshe, sigurisht se do të ndaj me familjen. Grua, 28 vjeçare, maqedonase.

Përveç mosbesimit ndaj institucioneve, si një prej barrierave kryesore për zbardhje të guximshme dhe publike të rasteve të korrupsionit gjinor theksohet edhe mendësia e njerëzve në vendin tonë, **stigmatizim i fuqishëm që e shoqëron gruan dhe tendenca që përgjegjësia të hidhet mbi gruan, me ç'rast ajo ballafaqohet me gjykim nga ana e publikut, cenohet autoriteti dhe integriteti i saj dhe ajo pëson ndjenjë të fajit dhe turpit për diçka për të cilën as vetë nuk është përgjegjëse.** Në këtë mënyrë gruaja nuk është vetëm viktimë e korrupsionit gjinor, por ajo duke folur publikisht bëhet viktimë ende më e madhe e sistemit dhe shoqërisë të cilët pa bazë e shpallin fajtores.

Sa më e mbyllur shoqëria dhe sa më konservative, aq është më lehtë të detyrohet dikush për shërbime seksuale si mënyrë e korrupsionit. Sepse burrat në funksion e kanë fuqinë (pushtetin) gratë nuk kanë të drejtë vote. Në shoqëritë e mbyllura, burrat konsiderojnë se kjo u takon sepse e dinë se ajo nuk do të tregojë, sepse kjo është turp, do t'ia bëjnë me gisht, do të përqeshet... Shpesh kur gruaja mbledh guximin të tregojë, vijojnë komente të llojit: "vetë e ke kërkuar"... dhe ngjashëm. Pra nuk do të thotë se vetë e ka kërkuar, por bëhet fjalë për prapambeturinë e shoqërisë. Grua, 45 vjeçare, maqedonase.

Pothuajse asnjë grua nuk paraqet rastin sepse kanë frikë të mos gjykohen dhe përqeshen. Siç tha dikush, duan ta harrojnë atë më shpejt. Kjo mund të zvarritet me vite dhe të mos pritni drejtësi asnjëherë. Më lehtë do të dëshmoni 'mobingun', që gjithashtu është shumë rëndë për të dëshmuar, sesa zhatjen seksuale. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Cila grua do ta çojë punën deri në fund në vendin tonë? Së pari do të gjykohet edhe po ta thotë atë publikisht. Menjëherë ka komente: “e ka kërkuar vetë, shihe si vishet, tërheq vëmendje” dhe ngjashëm. Së pari ato komente do t’i thonë gratë, pastaj të tjerët. Grua, 24 vjeçare, maqedonase.

Shumë rëndë. Së pari do të më etiketojnë, se vetë e ka shkaktuar atë. Nga shtëpia vështirë se do ta kuptojë dikush dhe do të reagojë qetë. Mund të hapet biseda edhe në shtëpi “vetë e ke kërkuar”. Nëse e paraqet në institucion, do të ngecë rasti në ndonjë sirtar. Situata shumë e keqe. Ende jemi primitiv lidhur me këtë temë. Me sa duket do të mbetet në duart e secilit prej nesh që të përballet me mençuri që të mos bëhet më keq. Grua, 48 vjeçare, maqedonase.

Një pjesë e pjesëmarrësve theksuan se njohin gra që kanë përjetuar korrupsion gjinor dhe të cilat që të mbrohen nga personi i cili i shantazhon, si dhe nga gjykimi i mjedisit e kanë pasur patjetër ta braktisin familjen dhe të shpërngulen nga qyteti, bile edhe nga shteti. Në disa raste gruaja viktimë e korrupsionit gjinor është lënë në situatë të ketë frikë ta ndajë përvojën në shtëpi me bashkëshortin ose prindërit, sepse ka frikë nga zemërimi dhe reagimi agresiv i tyre ndaj keqbërësit, dhe heshtin që të mos shkaktojnë pasoja serioze për familjen. Në shumicën e rasteve, gruaja është lënë të luftojë vetë, të mbrohet dhe sa më shpejt të dalë nga situata.

Vetëm unë dhe nëna dinim çfarë ndodh me vajzën, por ne nuk kishim fuqi të bëjmë diçka. Të shkonim të bisedojmë me të, asgjë, vetëm do ta turpërojmë vajzën dhe në fund vajza vendosi të japë dorëheqje nga puna dhe të mbrojë veten dhe prindërit – babanë, sepse shpërthen shumë. Mund të shkaktohej edhe konflikt më i madh. Askush nuk paraqiti rastin. Thjesht, vajza pas dy vitesh kur duhej të merrte vendim, ajo e la punën për shkak tij. Ai vazhdoi edhe më tej ta bezdisë në telefon. Megjithatë ajo e ndryshoi numrin dhe momentalisht është jashtë shtetit dhe u largua disi dhe shpëtoi. Grua, 53 vjeçare, maqedonase.

Më merakosi, kur e dëgjova njërin prej bashkëfolësve duke thënë “... e nëse i ndodh bijës sime kjo, unë dhe ai do t’i qërojmë hesapet!”. Këtu pak është edhe momenti si ta mbrosh familjen tënde në shtëpi që të mos shpërthejnë në atë moment. Nuk di. Është shumë e ndërlikuar, nuk ka ndonjë rrugë të drejtë që duhet ndjekur, nuk ka një përgjigje të saktë. Te ne nuk funksionon asgjë, gjithçka mbetet në vullnetin tuaj personal, kush si ndjehet në atë moment. Grua, 28 vjeçare, maqedonase.

Pjesëmarrëset nga përkatësitë etnike potencuan se kjo është shumë dominuese në kulturën dhe jetën e tyre të përditshme dhe ato theksojnë se nëse gruaja shqiptare ballafaqohet me zhvatje seksuale, ajo në shumicën e rasteve për këtë nuk flet as brenda në familje, për shkak të frikës nga gjykimi i burrit ose fëmijëve.

Nuk do ta kisha paraqitur, do të kisha pasur frikë. Do të ndjehem fajtores dhe nga frika nuk do të mund të tregoja. Fillimisht do të kisha turp nga fëmijët. Varësisht në cilën pjesë jetoni. Sepse te ne shqiptarët jeta është ndryshe. Te ne është më ndryshe, kërkoj falje nuk dua të bëj njëfarë diskriminimi.. por te maqedonasit është pak më ndryshe. Për mua nuk është problem, por për shoqet e mia në punën e tyre ato gjithmonë thonë: "Hesht, mund të jetë edhe më keq!". Unë i kuptoj ato, por nuk di si t'u ndihmoj, që të mos jemi ne viktimë. Grua, 34 vjeçare, shqiptare.

Por sinqerisht jam shumë e zhgënjyer. Të gjithë i kemi dëgjuar ato incizime "bomba" që dolën nga qeveria para disa vitesh. Njëra nga to ka pasur një bisedë të pahijshme mes një politikani dhe politikaneje që ka qenë në kontekst seksual, por mirë kjo është punë e tyre. Dua të theksoj se: Fajin e ka gjithmonë gruaja! Unë e konsideroj shoqërinë tonë seksiste. Viktima është femra. Ajo u tërhoq nga skena politike për shkak të atij "incizimi të turpshëm", dhe zotëria vazhdon karrierën e tij. Te ne turp është për gruan - ajo është e dënuar, dhe ai është shenjtori. Pra, unë nuk pashë një shembull shumë pozitiv në vendin tonë. Ishte jashtëzakonisht zhgënjyese për mua, për sa i përket ndjeshmërisë femërore për politikanen në fjalë dhe atë që ndodhi me të. Sepse tjetri respektohet dhe vlerësohet më tej në shoqëri. Reputacioni i saj dhe karriera e saj politike kanë mbaruar, ndërsa jo edhe karriera e tij. Çmimi që paguan një grua është shumë më i shtrenjtë. Grua, 40 vjeçe, shqiptare

Megjithatë, disa nga pjesëmarrëset deklaruan se do të gjenin një mënyrë për t'u hakmarrë për atë që bënë, duke anashkaluar institucionet. Në këtë drejtim, ata do të përdornin rrjetet sociale ku do të postonin incizim të një bisede me personin që kërkon zhvatje seksuale dhe do të përpiqeshin të zbulonin publikisht sjelljen e tij.

Pasi të gjithë ne jemi të lidhur me telefonat në çdo moment, do ta marr telefonin, do arrij disi ta incizoj dhe do ta ndaj me gjithë publikun. Unë do të zbuloj emrin dhe pozicionin e tij. Do të jem gati të humbas punën time, do të jem gati të përflitet emri im për një javë - dy apo edhe një muaj. Por, për të mirën më të madhe, kështu do ta sanksionoja atë njeri. Do ta lë të përballet me dënimin publik. Kjo është, për shembull, më së shumti që mundem të bëj personalisht. Pa iu drejtuar dhunës fizike. Grua, 35 vjeçare, maqedonase

Unë nuk do ta kisha paraqitur, por do ta kisha zbuluar publikisht. Ndoshta edhe në rrjetet sociale, por për një budallallëk të tillë, do të paguaj të ngjiten edhe afishe nëpër mure. Dhe ta dënojnë publikisht të gjithë. Grua, 45 vjeçare, maqedonase.

5.1 ÇFARË DO T'I KISHTE INKURAJUAR QË TA NDJEKIN RRUGËN INSTITUCIONALE?

Për shumicën e pjesëmarrësve, ky problem i ndërlikuar duhet të trajtohet përmes ndryshimeve serioze sistemore dhe institucionale. Në këtë drejtim, ata theksojnë se institucionet kompetente shtetërore dhe ministritë (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Drejtësisë, Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit, gjykatat, policia, etj.) duhet të funksionojnë, të punojnë siç duhet, të zbatojnë ligjet për të rikthyer besimin e dëmtuar rëndë të qytetarëve në punën e tyre profesionale.

Po ashtu, pjesëmarrëset theksojnë se vetëdija e qytetarëve për këtë problem do të rritet dhe besimi tek institucionet do të forcohet nëse do të ketë dënime të rënda për autorët e këtij lloji të veprave, pavarësisht nga niveli i pushtetit që ata kanë për momentin dhe nëse për to flitet hapur në media. Në këtë mënyrë, më shumë gra viktimë të korrupsionit gjinor do të inkurajoheshin të raportonin rastin.

Institucionet të funksionojnë. Sidomos Qendra e Kujdesit Social. Ta kryejnë punën e tyre. Të dihet se ai që do të revoltohet të jetë i mbrojtur. Grua, 45 vjeçare, maqedonase.

Gjithashtu, duhet të dimë se ai që do të kërkojë formë të tillë të korrupsionit do të dënohet bukur, që të mos përsëritet. Grua, 28 vjeçare, maqedonase.

Dhe të funksionojë gjyqësori, të ketë njerëz të tillë të dënuar, dhe të përcillet në media se dikush është sanksionuar. Duhet patjetër të ketë shembull pozitiv që të inkurajohet edhe dikush tjetër të paraqesë raste të tilla. Grua, 45 vjeçare, maqedonase.

Disa nga pjesëmarrëset theksojnë mbrojtjen e pamjaftueshme ligjore të grave viktimë të korrupsionit gjinor dhe mënyrën se si reagon policia ndaj këtij lloji akuzash. Së këndejmi, lind edhe domosdoshmëria për ndryshimin e ligjeve lidhur me këtë lloj abuzimi.

Në policinë gjithashtu, ka problem, ndërmerret diçka vetëm nëse është kryer ndonjë vepër. Vepër të kryer e konsiderojnë nëse dikush ka bërë dëm. E tani, nëse gruaja nuk është përdhunuar, për to nuk është vepër penale. Derisa gruaja nuk është dëmtuar, nuk e konsiderojnë si vepër penale. Ndërsa dëmin psikik nuk e konsiderojnë si vepër. Grua, 45 vjeçare, maqedonase.

Siç përmendi bashkëfolësja paraprake, të gjithë ato porosi SMS dhe biseda të incizuar do të pranohen dhe do të merren si dëshmi. Do të jetë pikënisje e mirë. Dëshmitarë që do të pranohen të flasin. Dhe më shumë gra që do të inkurajohen të flasin, të jemi më shumë dhe të kuptohemi më seriozisht. Dhe ta paraqesin atë njeri. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Unë mendoj se nëse ndonjë grua nuk di ku të drejtohet, së pari do të shkojë në polici. Me shpresë se do ta udhëzojnë drejt se çfarë hapa të ndërmarrë në tutje. Nëse institucionet e punojnë punën siç duhet, ndoshta do të inkurajohen më shumë gra të paraqesin rastet. Grua, 34 vjeçare, maqedonase.

Për shumicën e tyre, fakti se në pozitën udhëheqëse në institucionin të cilit duhet t'i drejtohen është grua, nuk do të ndikojë dukshëm mbi përgatitjen për ta paraqitur rastin. Sipas pjesëmarrëseve, në këtë proces është shumë me rëndësi funksionaliteti i institucioneve dhe profesionalizmi dhe integriteti i njeriut i cili është në pozitë udhëheqëse, e jo gjinia e tij.

Sepse nuk i besojmë sistemit, grua apo burrë është e njëjtë nëse nuk kemi shtet të së drejtës. Nuk përbën ndryshim fakti që është grua, do të jetë e ndjeshme me mua... Absolutisht nuk ndryshon asgjë. Grua, 35 vjeçare, maqedonase.

Profesionalizmi është i nevojshëm në raste të tilla, pa dallim nëse është burrë apo grua. Grua, 45 vjeçare, maqedonase.

Megjithatë, në rast se inkurajohen për ta paraqitur rastin, shumica e pjesëmarrëseve theksuan se shumë më lehtë do ta kenë të hapen dhe ta rrëfejnë hollësisht përvojën nëse bisedojnë me grua.

Mendoj se ndoshta do të jetë më lehtë që gruaja të shprehet në atë moment. Nuk do të thotë se do të ndihmojë, por vetëm për momentin gjatë rrëfimit. Grua, 34 vjeçare, shqiptare.

Qasjen do ta kemi më të natyrshme. Momenti i parë kur do ta bësh dëshminë e parë. Grua, 38 vjeçare, maqedonase.

Po, edhe unë e mendoj të njëjtën gjë. Fillimisht nëse rrëfimi ndahet me një femër, do të ndihesh më rehat sesa me një burrë, nuk do t'i anashkalosh detajet, unë personalisht do të ndihesha më e lirë dhe më e hapur me një grua. Por vetëm për shkak se është grua në atë pozicion, nuk mendoj se mund të bëjë diçka më shumë. Grua, 35 vjeçare, maqedonase

6. PROFILI I VIKTIMËS SË KORRUPSIONIT GJINOR

Të gjithë pjesëmarrëset në diskutim theksuan se viktimë e korrupsionit gjinor shpesh janë gratë që janë më të dobëta financiarisht, ekzistenca e të cilave varet fuqishëm nga vendi i tyre i punës dhe ato që janë pa burrë si mbrojtës në jetë (të divorcuarat, nënat e vetme ose të vejat).

Ato që janë financiarisht të varura, nënat e vetme, gratë e divorcuara, të vejat... ato që varen nga ai vend pune, mund të jenë më shumë të shantazuara. Dhe ato janë më shpesh viktima. Ato i konsiderojnë si persona që nuk kanë mbrojtje. Grua, 49 vjeçare, maqedonase.

Në vendin tonë, nëse pas saj nuk qëndron burrë, meshkuj, pra baba, vëlla i fuqishëm, mund të bëhet viktimë potenciale. Pra flas nga përvoja personale. Edhe po të mos bëhet fjalë për korrupsion dhe të bëhet fjalë edhe për ngacmim në internet, fjalën “jo” nëse e thotë ndonjë grua e cila është vetëm, llogaritet sikur të ketë thënë “po”. Grua, 40 vjeçare, shqiptare.

7. AKTIVITETI QYTETAR LIDHUR ME KORRUPSIONIN GJINOR

Të gjithë pjesëmarrëset në këtë hulumtim cilësor theksuan se do të shprehnin hapur opinionin e tyre kundër zhvatjes seksuale në rrjetet sociale dhe se do të nënshkruanin një peticion kundër zhvatjes seksuale si formë korrupsioni.

Mirëpo, për sa i përket protestës, disa nga pjesëmarrëset kishin dilema, për shkak të frikës nga etiketimi dhe pasojave të mundshme si humbja e vendit të punës, veçanërisht nëse janë të punësuar në administratë publike..

Nuk funksionon, sepse sërish ka frikë. Pra, nëse dalin për të protestuar, gratë kanë frikë se do të sanksionohen në një farë mënyre. Më shpesh, njerëzit kanë frikë nga protestat, për çfarëdo problematike: të mos etiketohen, të mos dënohen, largohen nga puna, të mos gjykojnë etj. Mendoj se shumë gra nuk do të kishin kurajë. Sepse tek ne nuk lejohen protesta për personat që janë të punësuar në sektorin publik, nëse kjo protestë nuk u konvenon pushtetarëve. Grua, 49 vjeçare, maqedonase

Ne ende jetojmë në një botë ku na intereson se çfarë thonë të tjerët për ne. Dhe njerëzit do të thonë; "Pse doli tani në protestë, duhet të jetë një prej tyre që ka qenë e korruptuar..." në këtë kuptim... jetojmë akoma për popullin. Mendoj se ky është gabimi ynë më i madh që po na pengon. Prandaj, ne nuk mund të shprehemi, t'i tregojmë njëri-tjetrit problemin, të gjejmë një zgjidhje. Gjithmonë ndjejmë frikë, shqetësim, turp nga njerëzit, çfarë dhe kush do të thotë diçka për ne. Grua, 34 vjeçare, maqedonase.

Gjithashtu pjesëmarrëset theksojnë se kur bëhet fjalë për peticione dhe protesta publike kundër zhvatjes seksuale si formë e korrupsionit, kjo nuk duhet të marrë formën e lëvizjes feministe, por përkundrazi nevojitet edhe mbështetje nga burrat në gjithë këtë proces.

Mendoj se problemi më i madh është besimi se vetëm gratë duhet të protestojnë për këto tema. Ne kemi një problem me përkrahjen. Kur edhe burrat të dalin në protestë, gratë do të jenë më të guximshme sepse kanë përkrahje, se dikush i kupton se nuk janë të gjithë njësoj e kështu me radhë. Grua, 45 vjeçare, maqedonase

Dhe të mos krijohet pasqyrë e rrejshme se gratë kanë dalë të protestojnë kundër burrave. Pra nuk janë të gjithë njësoj. Protesta është kundër atyre që kanë lejuar të kërkojnë shërbime të tilla. Dhe pajtohem se këtu duhet të përfshihen edhe burra, kështu do të japë mesazh më të fuqishëm. Grua, 49 vjeçare, maqedonase.

Unë vazhdimisht i mbështes të gjitha llojet e fushatave kundër dhunës ndaj grave. Tani këtu ka një problem të vogël që gjithçka duket paksa feministe. Rezulton sikur vetëm ne gratë mbështesim njëra-tjetrën. Disi bota mashkullore duhet të përfshihet më shumë këtu. Sepse edhe ato një ditë mund të jenë viktimë, jo vetëm gruaja. Edhe ata ta mbështesin gratë. Ndërsa me aktivitetet në rrjetet sociale nuk do të ketë efekt, do të ketë më shumë shikueshmëri nëse pëlqejnë postimet e tilla dhe i komentojnë. Të ndryshohet vetëdija publike. Flasin për një shoqëri tepër tradicionale dhe të kufizuar. Por me siguri do të ndërmerren disa hapa të vogla. Grua, 24 vjeçare, maqedonase

Gjithashtu, pjesëmarrëset theksojnë se është shumë e rëndësishme që organizimi i protestave të jetë i pavarur dhe të qëndrojë larg ndikimit politik dhe partive politike.

Te ne, kurdo që të protestohet për diçka, partia në pushtet thotë se këto protesta janë të organizuara nga opozita. Prandaj u bëhen presione të ndryshme njerëzve, për vendin e punës, shantazhe për fëmijët... Grua, 49 vjeçare, maqedonase.

Unë mbështes dhe jam anëtare e disa organizatave joqeveritare. Nëse protesta ka qëllim të qartë është në rregull. Vetëm të mos përzihet politika këtu. Te ne ekziston praktikë të fillojë bukur gjithçka dhe sapo të vijë ndonjë parti të japë mbështetje, e gjithë kjo merr përmasa tjera. Grua, 24 vjeçare, maqedonase.

Megjithatë, pjesëmarrëset theksojnë se që të ketë rezultat është me rëndësi që këto iniciativa të ngrihen dhe udhëhiqen nga persona që janë mjaft të fuqishëm dhe me autoritet në shoqëri dhe të cilat si të tilla, me mbështetje të mjaftueshme të publikut mund të sjellin ndryshim pozitiv në sistemin.

Por, duhet të na udhëheqë dikush. Dikush që është mjaft i fuqishëm dhe me autoritet. Që të na dëgjojë dikush, e kështu... siç thuhet "të rrahim ujë në havan"... do të jetë e kotë. Grua, 48 vjeçare, maqedonase.

